



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT

PËR REZULTATET E KONSULTIMIT PUBLIK TË PROJEKTVENDIMIT

**“Për miratimin e planit të menaxhimit të parkut arkeologjik
Bylis qytetet antike të Bylisit dhe Klosit, 2024-2029”**

1. Titulli i draft aktit

Projektvendimi “Për miratimin e planit të menaxhimit të parkut arkeologjik Bylis qytetet antike të Bylisit dhe Klosit, 2024-2029”

2. Kohëzgjatja e konsultimeve

Specifikoni kohëzgjatjen e përgjithshme të konsultimeve publike sa i përket ditëve të punës, përfshirë datën e hapjes dhe mbylljes së konsultimeve publike; nëse kohëzgjatja ishte më e shkurtër se 20 ditë pune e paraparë me ligj, jepni arsye për shkurtimin e kohëzgjatjes.

Konsultimi publik filloi me dëgjuesën e parë publike më datë 8.4.2024 deri më datë 7.5.2024 ditë ku u mbajt dëgjesa e dytë publike e cila përkoiu dhe me mbylljen e konsultimit publik në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike.

Konsultimet në portalin e Regjistrit Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike kanë zgjatur 20 ditë pune, 09.04.2024 – 07.05.2024, bazuar në ligjin 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”.

3. Metoda e konsultimit

Listoni të gjitha metodat e konsultimit të përdorura, të tilla si konsultimet elektronike (Regjistri Elektronik, posta elektronike, faqet e internetit, etj.), Takimet publike, seancat e organeve këshilluese..., dhe siguroni informacione për afatin kohor, kohëzgjatjen dhe afatet e tyre. Shpjegoni se si u shpërnda informacioni mbi konsultimet e hapura, si u ftuan palët e interesuara të kontribuojnë. Përfshini gjithashtu aktivitete nga konsultimet paraprake nëse janë organizuar të tilla).

Procesi i konsultimit publik të Planit të Menaxhimit është zhvilluar nëpërmjet disa metodave të konsultimit me qëllim përfitimin e ekspertizës mbi këtë fushë por dhe informimin dhe dakordësimin me të gjitha palët e interesit dhe të ndikuara.

- Takime konsultative të institucioneve shtetërorë përgjegjëse;
- Takime me grupet e interesit;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT

- *Takime me komunitetin lokal;*

Ky plan është hartuar në bashkëpunim dhe konsultim me një numër të madh të aktorëve të interesuar, institucione qendrore dhe lokale, përfshirë përfaqësues të Parkut Arkeologjik Apolloni–Bylis dhe komunitetin lokal. Për këtë arsye, u zhvilluan një sërë konsultimesh me përfaqësues të niveleve të ndryshme, me qëllim të arritjes së bashkëpunimit për idetë dhe konceptet. Takimet, prezantimet dhe anketimet, përfshirë pyetësorët dhe përgjigjet e publikut, grupet e interesit, u organizuan nga Zyra e AICS në Tiranë përmes takimeve në terren. Drejtuesit institucionalë të grupeve të interesit u trajtuan si partnerë të rëndësishëm në procesin e përgatitjes së këtij plani. Këtyre grupeve të interesit iu dërguan draftet e seksioneve, dhe takimet dhe prezantimet zhvilloheshin me frekuencë, duke krijuar kështu një bashkëpunim të ngushtë dhe marrëdhënie pune të mira reciproke.

Janë zhvilluar takime konsultative me përfaqësues të institucioneve qendrore përgjegjëse për Parkun Kombëtar Arkeologjik të Apollonisë – Bylis duke përfshirë Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit dhe Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura (AKZM).

Janë organizuar takime me përfaqësues të bashkive, Fier, Ballsh të cilat u përqendruan kryesisht te angazhimi në këtë proces të personave vendas me ndikim, kryepleqve në Hekal dhe Klos dhe vendimmarrësve në fushën e turizmit të qëndrueshëm, mjedisit dhe zhvillimit ekonomik.

Një rendësi të veçantë iu kushtua edhe komuniteteve lokale, që jetojnë përreth Parkut Arkeologjik Bylis ose brenda rrënojave arkeologjike të Klosit, nëpërmjet takimeve të drejtpërdrejta me banorët apo takimeve me kryepleqtë e fshatrave. Qëllimi i këtij procesi ishte përfshirja e një gamë sa më të gjerë përfituesish të drejtpërdrejtë dhe atyre personave me ekspertizë të veçantë vendore (shoqëri turistike dhe udhërrëfyes turistike, që kanë lidhje me burimet kulturore dhe natyrore, fermerët vendas, aktivistët e mjedisit dhe zejtarët vendas), për t'iu kërkuar këshilla mbi identifikimin e problematikave aktuale dhe zgjidhjeve të mundshme.

- *Dëgjesa Publike ;*

Procesi i konsultimit u përmbyll me mbajtjen e dy dëgjesave publike. Dëgjesa e parë publike u zhvillua në Parkun Arkeologjik të Bylisit në datën 8.04.2024. Në këtë dëgjesë morën pjesë përfaqësues nga Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore (IKTK), Institutit Arkeologjik/Akademia e Shkencave, specialistë arkeologë të njohur, Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore Vlorë, Institutit Kombëtar të Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore, Bashkisë Mallakastër Zyrës së Administrimit dhe Koordinimit të Parqeve Arkeologjike Apoloni dhe Bylis (ZAKPA), përfaqësues nga komuniteti, biznesi lokal, dhe Agjencisë Italiane të Bashkëpunimit për Zhvillim.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT

Dëgjesa e dytë u mbajt në Tiranë në datë 7.05.2024 në të cilën morën pjesë përfaqësues nga Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, nga Agjencia Italiane e Bashkëpunimit për Zhvillim, Akademia e Shkencave, Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore, Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore, Universiteti i Tiranës (Departamenti i Arkeologjisë dhe Trashëgimisë Kulturore), Delegacioni i BE në Shqipëri, Media-s, Kuvendit të Republikës së Shqipërisë dhe ekspertë të trashëgimisë kulturore.

4. Palët e interesit të përfshira

Listoni të gjithë palët e interesuara, qoftë organizata apo individë, të cilët kanë dhënë komente/kontribut në konsultimet publike përmes metodave të ndryshme të konsultimit, gjatë gjithë procesit të hartimit.

Përmendni gjithashtu numrin dhe strukturën e palëve të interesuara që morën pjesë në takime publike ose seanca të organeve këshilluese.

Specifikoni palët e interesuara që morën pjesë në grupin e punës për hartimin e aktit.

Plani është hartuar me kontributet e disa autorëve, specialistë të njohur kombëtarë dhe ndërkombëtarë të referuar në faqen 2 të draftit të rishikuar të PM, me ndihmën teknike të: Universiteti i Bolonjës, Rajoni Emilia-Romagna, Instituti i Arkeologjisë, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe inovacionit, Instituti i Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore.

Në procesin e konsultimit morën pjesë rreth 100 grupe interesi, ekspertë të fushës, qytetarë dhe institucione dhe organizata civile të cilat ndikohen nga ky projektvendim.

- Autorë ndërkombëtarë dhe kombëtar, ekspertë të fushës;
- Mbështetje teknike nga Universiteti i Bolonjës, Rajoni Emilia-Romagna;

Instituti i Arkeologjisë, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore;

- Universitetet dhe komuniteti akademik;
- Bashkitë;
- Komuniteti Lokal;
- Institucione shtetërore;
- Organizata civile të fushës;
- Qytetarët nëpërmjet RENJKP.

Në hartimin e këtij Plani kane kontribuar gjithashtu Zyra e Administrimit dhe Koordinimit të Parkut Arkeologjik Apoloni-Bylis, Bashkia Mallakastër si dhe aktorë të shumtë të interesuar, institucione qendrore dhe lokale, dhe komuniteti lokal.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT

Objektivi i takimeve me palët e interesuara ishte që të gjitha palët të zhvillonin të njëjtën kuptueshmëri dhe të dakordësonin mbi parimet e përgjithshme dhe mekanizmat e koordinimit, siç janë propozuar për Planin e Menaxhimit.

Procesi i konsultimit me palët e interesit përfshiu gjithashtu përfaqësues nga universitetet dhe akademikë të spikatur në fushat e arkeologjisë, menaxhimit të trashëgimisë kulturore, ekologjisë dhe mjedisit të cilët kontribuuan në identifikimin e problematikave prioritare dhe zgjidhjeve për t'u adresuar. Institucionet dhe palët e përfshira në konsultim Institucionet e interesuara Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Instituti i Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore (IKTK), Instituti i Arkeologjisë (IA), Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM), Parku Arkeologjik Apolloni-Bylis, Bashkia Mallakastër/Ballsh, Qendra Kulturore Bashkiake, Njësia Bashkiake dhe Komuniteti Hekal, Klos dhe Universiteti i Tiranës Relacion për projektvendimin “Për miratimin e planit të menaxhimit të Parkut Arkeologjik Bylis qytetet antike të Bylisit dhe Klosit, 2024-2029” 9 Grupet e interesit. Përveç institucioneve, një grup tjetër i rëndësishëm ishin komuniteti i grupeve të interesit të vendosur në zonën Mallakastër, Fier me veprimtari dhe interes në fushën e kulturës dhe mbrojtjen e trashëgimisë arkeologjike. Shoqata: Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Ballsh, Shoqata e Turizmit AAT-HORECA, Rotary Club, Trashëgimia Kulturore pa Kufij, Shqipëri Gjithashtu, janë organizuar seminare, takime dhe intervista me përfaqësues të bashkive të Ballshit dhe Fier, kryepreqve të fshatrave të Hekal dhe Klos, dhe fokus grupe të tjera.

Në vijim drafti i Planit ka qenë objekt i dy dëgjësive publike. Dëgjesa e parë publike u zhvillua në Parkun Arkeologjik të Bylisit në datën 8.04.2024. Në këtë dëgjese morën pjesë përfaqësues nga Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore (IKTK), Institutit Arkeologji/Akademia e Shkencave, specialistë arkeologë të njohur, Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore Vlorë, Institutit Kombëtar të Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore, Bashkisë Mallakastër Zyrës së Administrimit dhe Koordinimit të Parqeve Arkeologjike Apoloni dhe Bylis (ZAKPA), përfaqësues nga komuniteti, biznesi lokal, dhe Agjencisë Italiane të Bashkëpunimit për Zhvillim.

Dëgjesa e dytë u mbajt në Tiranë në datë 7.05.2024 në të cilën morën pjesë përfaqësues nga Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, nga Agjencia Italiane e Bashkëpunimit për Zhvillim, Akademia e Shkencave, Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore, Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore, Universiteti i Tiranës (Departamenti i Arkeologjisë dhe Trashëgimisë Kulturore), Delegacioni i BE në Shqipëri, Media-s, Kuvendit të Republikës së Shqipërisë dhe ekspertë të trashëgimisë kulturore.

1. Pasqyra e komenteve të pranuar me arsyetimin e komenteve të pranuar/refuzuara



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT

*Gruponi komentet/ propozimet e pranuar sipas çështjes që ato ngritën;
Gruponi komente të ngjashme së bashku dhe renditni palët e interesuara që i ngritën ato;
Shpjegoni cili ishte vendimi i marrë dhe sqaroni shkurtimisht arsyet për të.*

Çështja e adresuar (psh. përkufizimi i ri i..., kushtet për regjistrimin e..., rregullimi i..., etj.)	Komenti (grumbulloni dhe përmbledhni komente identike/të ngjashme nga palët e ndryshme të interesuara së bashku)	Palët e interesuara (renditni të gjithë ata që adresuan çështjen në mënyrë të ngjashme)	Vendimi (I pranuar/I pranuar pjesërisht/I refuzuar)	Justifikimi
Forma e Menaxhimit	Pse propozohet forma e menaxhimit nëpërmjet një fondacioni të krijuar nga MEKI dhe jo nje forme menaxhimi drejtpersedrejt nga MEKI? Znj. Ina Zhupa, pyeti nëse e mendojnë vërtetë menaxhimin direkt te Bylisit ?	Agjencia Italiane e Bashkëpunimit për Zhvillim, Akademia e Shkencave, Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore, Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore, Universiteti i Tiranës (Departamenti I Arkeologjisë dhe Trashëgimisë Kulturore), Delegacioni i BE në Shqipëri, Media-s, Kuvendit të Republikës së Shqipërisë dhe ekspertë të trashëgimisë kulturore.	I pranuar	Ndikon tërësisht në mënyrën se si do të administrohet pasuria



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT

Autorësia e draftit të PM dhe menaxhimi i tij.	Projekti duhet të kishte nisur implementimin në vitin 2021 dhe përfundimin në vitin 2024 prandaj drejtoi pyetjen se kur fillon zbatimi konkretisht dhe kur mbaron. Gjithashtu theksoi se te aktivitetet nuk cilësohet Qendër Multifunktionale por Muze i mirëfilltë Arkeologjik. Për sa i përket administrimit dhe menaxhimit, në dijeninë e tij në draftet e mëparshme të përcjella pranë Ministrisë së Kulturës nuk është propozuar krijimi i një fondacioni, por menaxhimi i drejtpërdrejtë publik. Pyetja e tij e fundit ishte se cilët janë autorët që kanë përgatitur draftin.	Tomor Luzati	Pranuar	Z. Ilir Parangoni, siguroi se në fokus të planit është zhvillimi lokal dhe afrimi i komunitetit dhe aspektit mjedisor është trajtuar me interes në Plan. Z. Adem Bunguri, drejtor Instituti i Arkeologjisë, në cilësinë e arkeologut përforcoi fjalën e kolegëve të tij, duke shprehur rëndësinë arkeologjike dhe historike të Parkut Arkeologjik Bylis dhe roli i Institutit të Arkeologjisë duhet të jetë më i fortë dhe më i pranishëm në këtë Plan Menaxhimi.
Ndryshimi i kufijve	Një banor i fshatit Hekal drejtoi pyetjen nëse kufijtë e Parkut Arkeologjik Bylis do të jenë sic janë sot apo do zgjerohen	Banorë	Pranuar	Z. Ilir Parangoni, sqaroi se siç u prezatua në Plan do të bëhet restaurimi i monumenteve dhe do të ngrihet



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT

	duke përfshirë dhe elementë të tjerë si peizazhi. Gjithashtu sugjeroi se duhet të marrin pjesë në zbatimin e planit arkeologët që kanë punuar në Bylis sepse e njohin shumë mirë historikun dhe vijimësinë. Pyetja e dytë që drejtoi ishte dhe se çfarë përfiton komuniteti nga ky P			një qendër multifunksionale. Për sa i përket administrimit të fondeve duhet të jemi më të kujdesshëm me shifrat që përmenden dhe nëse kërkohet informacion më i detajuar, duhet bërë një kërkesë me shkrim
Menaxhimi i fondeve	Cfarë është bërë dhe çfarë do të bëhet me 6 milion euro të ofruar nga BE?	Përfaqësues nga Media	Pranuar pjesërisht	Sqarimi është dhënë në funksion të qartësisë së Planit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT

c) Afatet e vlefshmërisë së PM.	Cilat janë afatet e vlefshmërisë/zbatimit të planit?	Përfaqësues nga Media	Pranuar	Zbatimi i planit është ndarë në tre periudha: afatshkurtër (2024-2026), afatmesëm (2027-2029) dhe afatgjatë (2030+).
Regjistrimi i Bylisit në UNESCO.	Mungesa e një plan për regjistrimin e Bylisit në UNESCO.	Departamenti i Arkeologjisë dhe Trashëgimisë Kulturore (DATK), në Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë, Universiteti i Tiranës	Pranuar	Ky koment është reflektuar në draftin final të rishikuar të PM.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT

a) Formën e propozuar menaxhimit.	DATK mbështet një model menaxhimi direkt në ndryshim nga një modeli i menaxhimit me anë të një fondacioni i propozuar në draft PM.	Departamenti i Arkeologjisë dhe Trashëgimisë Kulturore (DATK), në Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë, Universiteti i Tiranës.	Pranuar	Ky koment është reflektuar në draftin final të rishikuar të PM.
b) Restaurimin e monumenteve në parkun arkeologjik të Bylisit.	Restaurimin e monumenteve në parkun arkeologjik të Bylisit, me ringritje dhe rikonstrukcion plotësues të tyre, e cila konsiderohet praktikë të papranueshme dhe cenuese të integritetit të vlerave kulturore. . Ndërhyrjet me karakter konservues do të realizohen përmes përgatitjes fillimisht të një plani konservimi të detajuar dhe hartuar nga ekspertë të fushës që do të miratohet më pas sipas kuadrit ligjor për trashëgiminë kulturore në vend.	Departamenti i Arkeologjisë dhe Trashëgimisë Kulturore (DATK), në Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë, Universiteti i Tiranës Tiranës.	Pranuar	b) Ky koment është reflektuar në draftin final të rishikuar të PM. Ndërhyrjet me karakter konservues do të realizohen përmes përgatitjes fillimisht të një plani konservimi të detajuar dhe hartuar nga ekspertë të fushës që do të miratohet më pas sipas kuadrit ligjor për trashëgiminë kulturore në vend. Vendimi për mënyrat e ndërhyrjeve teknike mbi monumente do të



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT

c) Problematika me lidhje me kërkimin arkeologjik.	Problematika me lidhje me kërkimin në sitin e Bylisit: mënyra se si brendia e sitit ofrohet tek publiku dhe mënyra se si do të trajtohen të dhënat e mbledhura nga gërmimet arkeologjike	Departamenti i Arkeologjisë dhe Trashëgimisë Kulturore (DATK), në Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë, Universiteti i Tiranës Tiranës	Pranuar	merren nga këshillat përkatës të MEKI-t. Ky koment është reflektuar në draftin final të rishikuar të PM.
Plani për prezantimin e sitit.	d) Të jepen Detaje mbi Planin për prezantimin e sitit.	Departamenti i Arkeologjisë dhe Trashëgimisë Kulturore (DATK), në Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë, Universiteti i Tiranës Tiranës.	Refuzuar	d)Prezantimi dhe vlerësimi (valorizimi) i sitit në draftin e rishikuar të PM është një komponent thelbësor. Ai është i ndarë në tre pjesë: muzeu fizik, muzeu i hapur/scuola



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT

Vizioni për planin	dh) Mungesa e vizionit lidhur me planin për programet e edukimit	Departamenti i Arkeologjisë dhe Trashëgimisë Kulturore (DATK), në Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë, Universiteti i Tiranës Tiranës.	Pranuar	cantiere dhe interpretimi digjital. Prezantimi dhe interpretimi i aspekteve të ndryshme në jetën urbane të tilla si ekonomia, dinamika sociale, politike dhe kulturore do të hartohen me ekspertë të fushës. Kjo do të arrihet duke respektuar parimet e Kartës së ICOMOS-it për Interpretimin dhe Prezantimin e siteve të Trashëgimisë Kulturore. dh) Ky koment është reflektuar në draftin final të rishikuar të PM në të cilin është parashikuar ngritja e kapaciteteve lokale përmes trajnimeve brenda kuadrit të “Scuola Cantiere” nën Universitetin e Bolognës.
--------------------	--	---	---------	---



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT

				Projekti “BE për Zhvillimin Ekonomik të Drejtuar nga Turizmi, Zhvillimi Ekonomik dhe Vendor me Fokus mbi Trashëgiminë Kulturore” do të financojë këtë komponent, i cili përfshin trajnimet për personelin e Parkut Arkeologjik Bylis dhe Klos, institucione të trashëgimisë kulturore dhe studentë të fushës.
--	--	--	--	---